



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:286122
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622059

C.nr.9496/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike të paditëses Sh.G nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N.H, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen juridike kompensim i pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shpërblimi jubilar, jashtë seancës me datë 25.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.G nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit t’ia paguaj shumën prej 1,377.00 €, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës 50% të një page bazë në shumë prej 229.00€, apo shumën e përgjithshme prej 1,606.00€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë 20.12.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër kërkesëpadia e paditëses Sh.G nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që e paditura Komuna e Prishtinës, në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shpërblimit jubilar, në shumë prej 2.00€ (dy euro).

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datë 20.12.2021 në gjykatë ka paraqitur padi për kompensimin e 3 pagave përcjellëse pas pensionimit dhe kompensimin e shpërblimit jubilar. Në padi ka theksuar se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura me kontratë të punës në SHFMU 28 Nëntori në Prishtinë në pozitën mësimdhënëse e Edukatës Qytetare dhe këtë pozitë e ka mbajtur deri në arritjen e moshës së pensionit me datë 23.10.2021. Tutje ka shtuar se paditësja në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon e drejta e realizimit të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse pas pensionimit. Me datë 22.01.2024 i autorizuari i paditëses ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në aspekt objektiv ashtu që në emër të tri pagave përcjellëse sipas lartësisë së pagës neto prej 459.00€ ka kërkuar shumën prej 1,377.00€ ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës, 50% të pagës ka kërkuar shumën prej 229.00€. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadiën e paditëses ta aprovoj në tërsi të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi ka theksuar se e konteston në tersi kërkesëpadisë e paditësve për arsye se paditësi nuk ka ofruar prova materiale se i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se ti drejtohet gjykatës me padi, tutje ka shtuar se kompensimet të cilat kërkohen me padi nuk janë paraparë me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 dhe rrjedhimisht e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linjë të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj në tersi.

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykata konstatoi se paditësja Sherife Gashi, ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht ka qenë e punësuar në vendin e punës si Mësimdhënëse e Edukatës Qytetare në SHMT “28 Nëntori” në Prishtinë dhe në bazë të vendimit për pensionimin e punëtorit të lëshuar nga e paditura - Sektori i Burimeve Njerëzore 14.Nr.118/02-198844/21 të datës 27.09.2021, paditësës i është përfunduar marrëdhënia e punës nga data 23.10.2021. Ndërsa nga lista e pagave për paditësen EM vërtetohet se paditësja ka pranuar pagën bazë në shumën prej 459.00 Euro. Gjithashtu nga vërtetimi nr.prot.27/2021 i dt 15.12.2021 i lëshuar nga SHMT 28 Nëntori në Prishtinë vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës me të paditurën nga data 18.09.2001 deri me 01.09.2007, ku pastaj është rikthyer sërish në punë me datë 01.09.2011 dhe ka punuar deri me 23.10.2021. Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësës për kompensimin e 3 pagave përcjellëse pas pensionimit gjen mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit 01/B-105 të vitit 2021. Çështja e kompensimit të 3 pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, parashihet me dispozitën e nenit 35, paragrafi 9 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ku përcaktohet se *“Punëtorët (antarë të SHBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”*. Ndërsa, sipas pika 9.1 te të njëjtit neni: *“Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionimit”*.

Në rastin konkret Gjykata gjeti se e paditura ka pasur për obligim t'ia paguaj paditëses tri paga përcjellëse pas pensionimit në lartësi të 3 pagave mesatare, dhe ky detyrim i të paditurës në raport me paditësen rrjedh në bazë të nenit 35 par. 9 i KKAK-së, mirëpo edhe përkundër këtij detyrimi, e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj që brenda afatit 30 ditor nga dita e pensionimit t'ia paguaj paditëses 3 paga përcjellëse pas pensionimit. Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për tri paga përcjellëse mori për bazë listën e pagave EM00003204 për muajt Gusht Shtator Tetor, nga e cila rezulton se paditësja në këta muaj ka realizuar pagë bazë në shumën prej 459.000€, e cila kur të shumëzohet me 3, sipas përlllogaritjes 459.00€ x 3 del shuma prej 1,377.00€ e cila i takon paditëses e të cilën edhe e ka aprovuar kjo Gjykatë.

Ndërsa çështja e shpërblimit jubilar rregullohet me nenin 35 paragrafi 8 pika 8.4 të KKAS-së ku parashihet se për *10 vite të përvojës së punës, të punësuarit i takon kompensimi në lartësi prej 50% të një page bazë*. Gjykata gjeti se kërkesa e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar është e bazuar për faktin se nga vërtetimi mbi përvojën e punës vërtetohet se paditësja ka themeluar marrëdhënie të punës me datë 18.09.2001 deri me 01.09.2007. Edhe pse paditësja ka pasur ndërprerje të marrëdhënies së punës e njëjta është rikthyer në punë me datë 01.09.2011 dhe ka punuar deri me datë 23.10.2021 (kur ka arritur moshën e pensionit), andaj nën këtë gjendje faktike rezulton se me datë 01.09.2021 paditësja ka arritur vitin jubilar për 10 vite përvojë të punës, pra në kohën që paditësja ka arritur vitin jubilar për 10 vite përvojë të punës i ka patur pandërprere deri në pensionim dhe Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021 ka qenë në fuqi pasi që e njëjta gjen zbatim për periudhën 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022. Pra gjykata vlerëson se mbi bazën e të lartcekurave paditëses i takon e drejta e realizimit të kompensimit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës. Lidhur me lartësinë e shpërblimit jubilar, nga lista e pagave për paditësin nr.EM vërtetohet se paditësja ka pagë bazë prej 459.00€, andaj 50% e pagës bazë rezulton të jetë shuma prej 229.00€, të cilën detyrohet e paditura t'ia paguaj paditëses.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në lartësi prej 2 euro, gjykata erdhi pas mbledhjes së shumave të aprovuara në emër të 3 pagave përcjellëse prej 1,377€, si dhe shpërblimi jubilar në shumë prej 229.00€, që të dy kërkesat arrijnë lartësinë prej 1,606.00 e jo në shumën prej 1,608.00€, sa ka kërkuar i autorizuari i paditëses në precizmin e kërkesëpadisë. Si rrjedhojë gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditëses në lartësi prej 2 euro, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në dy rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, si dhe lidhur me faktin se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: *“Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”*. Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e këtyre Kontratës, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratave Kolektive të lartcekura, në njërin anë janë paraparë të drejta për njërin palë, e në anën janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohen pengesë që paditësja t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 20.12.2021, e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par.1 i LPK-së, dhe të njëjtat i referohen shpenzimeve për përpilim të padisë 104.00 euro si dhe taksa gjyqësore për padi 20.00 euro, gjithsej 124.00€.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.9496/21, datë 25.04.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.